Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit 1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës 1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare;
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Kundër vendimit të autoritetit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës Ekonomike

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Termat e Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit.....

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Formulari 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë
(në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____ —
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					

Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt _____, është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 6 .

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

I. Sasia e dokumenteve të cilët do të duhet të kalojnë në procesin e skanimit dhe indeksimit është sipas tabelës së mëposhtme

TIPOLOGJIA E DOKUMENTIT	SASIA (FAQE/IMAZHE)	FORMATI
Dokumente Arkivore Historike	1,159,451	Skanim me ngjyra, nga formati me i vogël deri A4, kryesisht A4
Fond i Marrëveshjeve Ndërkombëtare	79'000	Letër A4–A3

II. Skanimi i Dokumentave Arkivore dhe parametrat teknikë.

Skanimi është komponenti themelor i procesit të digjitalizimit dhe kërkon pajisje profesionale. Cilësia e skanimit ndikon drejtpërdrejt në vlerën e arkivit dixhital të krijuar.

Bazuar në eksperiencën e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave (DPA) dhe standardet ndërkombëtare ISO, rekomandohen parametrat e mëposhtëm minimal të skanimit:

- Ngjyra: skanim me ngjyra të plota
- Rezolucioni: minimum 300 dpi për dokumentet standarde.
- Thellësia e ngjyrave: 24-bit true color për dokumentet me ngjyrë
- Formati i daljes: TIFF (pa humbje cilësie, lossless) si format primar i arkivimit dhe PDF/A si format dytësor i shpërndarjes me funksionalitet OCR të integruar.
- OCR: Konvertimi me Optical Character Recognition (OCR) duhet të kryhet mbi të gjitha dokumentet me tekst të shtypshkrimit për të mundësuar kërkimin elektronik të fjalëve kyçe.
- Faqet me informacion të dyanshëm (para/prapa): duhet të skanonhen si dy imazhe të ndara, ku faqja e pasme emërtohet me shtojcën ".1" (p.sh.: F.152, V.1934, D.254, fl.23 dhe fl.23.1).

III. Pajisjet e Skanimit, të dhënat teknike.

Për natyrën heterogjene të materialit arkivor (dokumente të vjetra delikate, format të ndryshme, mikrofilma, harta), rekomandohet përdorimi i pajisjeve profesionale të specializuara.

a) Skaner Rotativ Profesional — për skanimin e masës kryesore të dokumenteve (periudha 1912–1950). Ky lloj skaneri garanton mosdëmtimin e letrës delikate dhe të vjetër. Rekomandohen te perdoren skanerë rotativë me transmision me sfera çeliku (jo rripa ose gomina), me kapacitet ADF 500 faqe +, rezolucion optik 600 dpi, dhe me nje shpejtesi 240 ipm, modalitet simplex dhe duplex njëkohshëm, dhe që të funksionojë pa limit ditor (24/7).

b) Skaner Profesional i Mesëm — për dokumentet e periudhës 1945–2009 me cilësi letre më pak delikate. Pajisja duhet të mbështesë modalitetin Flatbed dhe ADF (kapacitet ≥ 100 faqe), rezolucion 300–600 dpi, simplex dhe duplex, dhe format dalje TIFF, PDF me OCR.

c) Skaner Planar A3 Tip Libri (Bookscan) — për dokumentet e vjetëra të dëmtuara, dokumente me format të çrregullt, kallke shumë të hollu, harta deri A3, regjistrat dhe dokumente të lidhura. Ky skaner duhet të ketë mbajtës libri në formë "V", ndriçim natyral dhe LED, kontroll automatik nga softëare ose me pedal, dhe shpejtësi skanimi ≤ 1.5 sekonda/faqe.

IV. Indeksi i Dokumentave

Indeksi dhe metadatat janë shtyllat e sistemit dixhital. Pa një indeksim korrekt dhe të detajuar, vlera operative e arkivit dixhital reduktohet ndjeshëm. Rekomandohet adoptimi i një strukture standarde metadatash.

Struktura e Rekomanduar e Metadatave

Nr.	Fusha e metadatës	Shpjegimi
1	MEPJ	Institucioni krijues: Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme
2	Viti (V)	Viti i krijimit të dokumentit (p.sh.: V. 1934)

Nr.	Fusha e metadatës	Shpjegimi
3	Dosja (D)	Numri i dosjes brenda fondit (p.sh.: D. 254)
4	Faqja (fl)	Numri i faqes / imazhit (p.sh.: fl. 23)
5	Faqja e pasme	Emërtimi i faqes së pasme me shtojcën ".1" (p.sh.: fl.23.1)

Konventat e Emërtimeve

Emërtimi i skedarëve dixhitalë duhet të ndjekë një konventë standarde dhe të qëndrueshme. Format i rekomanduar është:

MEPJ_F[nr.fondit]_V[vit]_D[nr.dosjes]_fl[nr.faqes].[TIFF/PDF]

Shembull: MEPJ_V1934_D254_fl23.tiff

Magazinimi i Dokumentave të Digjitalizuara

Magazinimi dixhital i sigurt është kusht thelbësor për ruajtjen afatgjatë të arkivit historik. Materialet e digjitalizuara do të ruhen dhe memorizohen në pajisje profesionale të dedikuara për magazinim. Me përfundimin e procesit të digjitalizimit dhe dorëzimin e pajisjes NAS, të gjithë dokumentet e digjitalizuara duhet të arkivohen në databazën qendrore të MEPJ, duke siguruar akses të organizuar dhe të strukturuar për të gjithë fondin arkivor digjital. Pajisja NAS do të shërbejë si backup i sigurt dhe i dedikuar, duke garantuar aksesueshmërinë e pandërprerë të dokumentave të digjitalizuara. NAS duhet të ruhet sipas logjikës WORM (lejohe vetëm krijimi i dokumentit dhe nuk lejohet fshirja apo modifikimi). Gjithashtu rekomandohet që të krijohet kopje offline ose “cold storage” nga MEPJ kur të kalojnë në sistemin qendror.

V. Pajisja NAS (Network Attached Storage)

Eksperti rekomandon përdorimin e një pajisjeje NAS (Network Attached Storage) profesionale si infrastrukturë kryesore e magazinimit. Kjo pajisje, në fund të projektit, kalon në pronësi të MEPJ, bashkë me të gjithë informacionin dixhital që ruan.

Karakteristikat teknike minimale të rekomanduara për pajisjen NAS duhet të jenë:

- Konfigurim RAID 6 ose ekuivalent me tolerancë të dështimit (fault tolerance) — garanton mbrojtje ndaj humbjes së të dhënave edhe në rast të dështimit të dy disqeve fizike.
- 4 x Hard disk me kapacitet minimalisht 12 TB secili me redundancë dhe hot-swap — zëvendësim i diskut pa ndërprerë operacionin.
- Kapacitet i mjaftueshëm për ruajtjen e të gjithë fondit dixhital të MEPJ sipas volumit përfundimtar të projektit.
- Kompresim lossless (pa humbje cilësie) i skedarëve TIFF — ruajtja e besnikërisë 100% ndaj origjinalit dixhital.
- Lidhje me rrjetin LAN të brendshëm të MEPJ, pa akses në internet (rrjet i mbyllur për siguri).
- Mbështetje e protokolleve standarde të sigurisë: enkriptim i të dhënave, kontroll aksesit me rol, log aktiviteti.
- Mundësi operimi WORM
- Firmëare me mundësi perditësimi dhe mirëmbajtje proaktive.
- Garanci 2 vjeçare pas periudhës së dorëzimit të pajisjes NAS.

VI. Formati i Ruajtjes dhe siguria e informacionit

Dokumentacioni dixhital duhet të depozitohet në dy formate komplementare:

- TIFF (lossless): formati primar i arkivimit — ruhet pa asnjë humbje informacioni; rekomandohet për ruajtje afatgjatë.
- PDF/A me OCR: formati dytësor i aksesit — lejon kërkimin me fjalë kyçe dhe shpërndarjen e kontrolluar. Ky format duhet të shoqërohet me gjithë infrastrukturën hardëare dhe softëare për realizimin e OCR.

Për shkak të natyrës konfidenciale të pjesës së dokumentave të MEPJ-së, magazinimi dixhital duhet të plotësojë standardet e sigurisë së informacionit. Rrjeti LAN i procesit të skanimit dhe magazinimit duhet jetë i mbyllur (pa akses në internet). Aksesit në sistemin dixhital të dokumentave duhet të kontrollohet me kredenciale individuale dhe të jetë i audituar. Çdo transferim i të dhënave duhet të jetë i dokumentuar. PC e përdorur për procesin e skanimit do duhet të fshihen të dhënat në mënyrë të sigurtë sipas DoD 5220.22-M (3-kalime), NIST 800-88 dhe IEEE 2883 ose me anë të shkatërrimit fizik të HDD/SSD/USB. Personat e autorizuar nga MPEJ duhet të supervizojnë dhe dokumentojnë këtë proces.

VII. Trajnimi i personelit dhe plani i trajnimit.

Trajnimi i personelit të MEPJ është i domosdoshëm për qëndrueshmërinë e sistemit dixhital pas përfundimit të projektit. Rekomandimet e mëposhtme kanë si qëllim të sigurojnë që stafi i MEPJ të jetë plotësisht kompetent për të menaxhuar, aksesuar dhe mirëmbajtur arkivin dixhital.

Gjatë muajit të parë të projektit, ekipi i specializuar duhet të kryejë trajnimin e plotë të punonjësve të DAHD pranë MEPJ. Trajnimi duhet të mbulojë:

- Kuptimin e strukturës së arkivit dixhital dhe të sistemit të indeksimit (metadat, konventat e emërimit të skedarëve).
- Përdorimin e softëare të skanimit dhe indeksimit: hyrja e metadatave, verifikimi i cilësisë, korrigjimi i imazheve.
- Procesin e kontrollit të cilësisë: si të verifikohet korrektësia e metadatave dhe lexueshmëria e imazheve.
- Menaxhimin e pajisjes NAS: aksesit, menaxhimi i hapësirës, verifikimi i integritetit të të dhënave.
- Procedurat e sigurisë: aksesit i kontrolluar, politikat e backup, raportimi i incidenteve.
- Procedurat e dorëzimit dhe kthimit të dosjeve fizike (procesverbalet, kartelat e dorëzimit).
- Trajnimi i personelit të MEPJ do të realizohet nga OE muajin e parë të shërbimit gjatë një afati 5 ditor

VIII. TË TJERA

- Identifikimi dhe përgatitja e dokumentacionit që do të kalojnë në proces skanimi do të realizohet në bashkëpunim me specialistet e autoritetit kontraktor.

- Shërbim skanimi, indeksimi të dokumenteve, regjistrim, magazinim të dokumenteve të digjitalizuar do të realizohet çdo ditë , duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës deri në përfundim të shërbimit 31.12.2026
- Autoriteti kontraktor kërkon nga Operatori Ekonomik ofertues që të skanojë më së shumti rreth 13.000 dokumenta në ditë në të gjitha postet e skanimit
- Trajnimi i personelit të MEPJ do të realizohet nga OE muajin e parë të shërbimit gjatë një afati 5 ditësh.
- Afati i montimit të pajisjeve dhe përgatitjes së infrastrukturës së digjitalizimit duhet të jetë jo më shumë se 4 (katër) ditë pune.

Bazuar në kërkesat e mësipërme, komisioni vendosi të saktësojë zërat përkatës në funksion të realizimit të këtij shërbimi:

1. Skanimi i Dokumentave Arkivore.

1. Skanim me ngjyra, nga formati më i vogël deri në A4, me rezolucion minimum 300dpi për dokumentet standarte.

Formati fillestar i daljes: TIFF dhe Format dytësor: PDF/A, me funksion OCR.

2. Skanimi me ngjyra i dokumenteve, A4- A3.

Formati daljes: TIFF.

Formati fillestar daljes: TIFF dhe Format dytësor: PDF/A, me funksion OCR.

4. Indeksim të dokumenteve, regjistrim, magazinim të dokumenteve të digjitalizuara.

5. Pajisja NAS (Network Attached Storage) konfigurim RAID 6 ose ekuivalenti

4 HD x 12 TB, operim në WORM.

6. Trajnim i personelit.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen: “Digjitalizim i arkivit historik”

Nr	Emërtimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Vendi ekzekutimit
1	Skanim me ngjyra, nga formati më i vogël deri në A4, indeksimi	Faqe	1,159,451	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
2	Skanimi me ngjyra i dokumenteve, A4- A3, indeksimi	Faqe	79,000	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
3	Pajisje NAS, konfigurim RAID 6 ose ekuivalenti, funksionim worm 4 HD x 12 TB	copë	1	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
4	Trajnim i personelit	Dite	5	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

1. Skanim me ngjyra, nga formati më i vogël deri në A4, me rezolucion minimum 300dpi për dokumentet standarde.

Formati fillestar i daljes: TIFF dhe Format dytësor: PDF/A, me funksion OCR.

2. Skanimi me ngjyra i dokumenteve, A4- A3.

Formati daljes: TIFF.

Formati fillestar daljes: TIFF dhe Format dytësor: PDF/A, me funksion OCR.

3. Indeksime të dokumenteve, regjistrim, magazinim të dokumenteve të digjitalizuara;

4. Pajisja NAS (Network Attached Storage) konfigurim RAID 6 ose ekuivalenti

4 HD x 12 TB, operim në WORM;

5. Trajnim i personelit;

Afati i ekzekutimit: nga data e nënshkrimit të kontratës deri në datën 31.12.2026

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Digjitalizim i arkivit historik”

Detyrat: Sipas specifikimeve teknike në shtojcën 6

Shpërndarja: Sipas specifikimeve teknike në shtojcën 6

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: pranë autoritetit kontraktor Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Shtojca 9.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, në përbërje të cilit të ketë të pakten 2 (dy) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- 1 (një) Inxhinier i diplomuar në Informatik / Teknologji Informacioni / Elektronik ose çdo arsim tjetër i ngjashëm, i cili të sigurojë instalimin, mirëmbajtjen e pajisjeve gjatë zbatimit të kontratës sipas specifikimeve teknike.
- 1 (një) specialist informatike ose teknologji informacioni.

Në lidhje me stafin teknik të paraqitet :

- Diplomë Universitare;
- Kontratë pune (e vlefshme);
- CV personale për secilin punonjës;
- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

Nr.	Emërtimi	Njësi	Sasi
1.	Skaner Rotativ Profesional	copë	1
2.	Skaner Profesional i Mesëm	copë	1
3.	Skaner Planar A3 Tip Libri (Bookscan)	copë	1

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

-
- a. Dokumentacion për pajisjet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerive pajisjeve të kërkuara.
 - b. katalog/skedë teknike të prodhuesit, ku të tregohen qartë karakteristikat e pajisjeve, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se disponon dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme), si më poshtë:

- S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente;

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se merr përsipër instalimin, montimin, shërbimin e skanimit, konfigurimin, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemit si dhe trajnimin e stafit.

2.3.6 Operatores ekonomike duhet të paraqesin një deklaratë me anë të së cilës të deklarojnë se marrin përsipër transportin e pajisjeve të kërkuara në pikën 2.3.3 në adresën e Autoritetit Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarimenëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare

nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
